



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK
PROJEKT - VENDIM
Nr. _____ datë _____ 2023

“PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM”
PËR VENDOSJE STACIONESH, BAZAMENTE PËR PANELE FOTOVOLTAIKE
ME QËLLIM PRODHIMIN E ENERGJISË”

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”.
- Te ligjit nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenin 25 pika 1
- VKM nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 45 (dyzet e pesë) ha për “vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë” në ngastrat nr 59/a,65/b,66/b dhe 75/e në ekonomine pyjore “Labinot” me një afat 10 (dhjetë) vjet nga lidhja e kontrates.
2. Vlëra vjetore dysheme e dhënies në përdorim të jete sipas studimit teknik-ekonomik dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Konceptoi: Q.Poka

Pranoi: J.Bodurri

Miratoi: Sh.Çullhaj

Dr.Juridike: A.Hoxha

KRYETAR

Lutfi Lala

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ 2023



